



Biografi e shkurtër

Znj. Lindita Varesi, pasi u diplomua si ekonomiste nga Fakulteti Ekonomik i Tiranës, (aktualisht Dega 'Ekonomiks' me 9.1/10), u punësua pranë Raiffeisen Bank Shqipëri Sh.A. (ish Banka e Kursimeve), Dega Sarandë ku punoi si Drejtuese e Aktivitetit Bankar në Valutë.

Znj. Varesi iu bashkua Bankës Kombëtare Greke, Dega Shqipëri Sh.A. në Shkurt të vitit 2006 ku ka punuar në pozicione të ndryshme dhe zhvilluar një karrierë të suksesshme me kulmim Drejtuese e Rrezikut të Huadhënies së Biznesit të Vogël, Divizioni i Riskut, Drejtuese e Analistëve Procesues të Kredihënies, Divizioni i Huadhënies së Kompanive Tregtare, Drejtuese e Departamentit të Pajtueshmërisë, Divizioni i Pajtueshmërisë, e trainuar profesionalisht për Drejtimin e Zbutjen e Rrezikut të Kredisë pranë NBG Athinë, Greqi, në Kontabilitetin Financiar & Banking po në Athinë, e certifikuar në Luksemburg për çështjet e krimit financiar/AML/CDD dhe Përputhshmërinë Rregullative. Paralelisht, ka vijuar studimet dy vjeçare për Menaxhim Biznesi & Administrim (M.B.A.), specialiteti Kontabilitet & Bankë, e u diplomua me rezultate shumë të mira nga IUKB (Institut Universitare Kurt Bosch)/Switzerland/UNYT (5.04/6), certifikatë e ekuivalentuar nga UK NARICK (The National Recognition Information Centre for the United Kingdom).

Znj. Varesi, mban gradën Doktore e Shkencave Ekonomike (9.24/10); është pjesëmarrëse në shumë Konferenca Shkencore; publikuese e një numri studimesh individuale shkencore me subjekt sistemin ekonomik-financiar dhe problemet që reflektojnë segmente/sectorë të ndryshëm të tij si ai bankar, i sigurimeve etj.,

Është pjesë aktive e jetës akademike, lektore dhe seminariste në disa prej fakulteteve private e publike operative në Tiranë; zotëron dy gjuhë të huaja Anglisht (C1) dhe Greqisht (rrjedhshëm). Duke aderuar për një shoqëri vlerash, Znj Varesi iu bashkua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit më 01 Shkurt, 2018 si pjesë e strukturës së Njesisë Ligjore, me detyrën Këshilltare Ekonomike.